

**Endrike da Mënaj**

## **E LIRË PËR TË DASHURUAR**

**( Poezi )**

**Tetovë, 2016**

## Në vend të parathënies për poezitë nga shpirti

Keda!

Nuk kisha ndërmend që të shkruaja diçka për librin tënd të parë, por, nuk doja që të mbetesha në libër si hije karshi kësaj begatje letrare, të paktën pa e thënë një fjalë, që emëruesh i përbashkët t'i mbetet fjala: të lumtë bija ime, ngase e di mirë, që për librin tënd të parë me poezi nuk mund që të gjej fjalë më të bukura për të vlerësuar poezitë e tua, sesa bashkëluftëtari im i luftës dhe i penës shkrimtari Rami Kamberi.

Nektarin e shpirtit tënd derdhur nëpërmjet poeziive në këtë libër dhe vlerësimin e Ramiut si redaktor dhe si kritik letrar i përsosur, nuk mund ta arrijnë fjalët e mia. Por ja, ti vetë më ngacmove me padurimin tënd për të dalë ky libër sa më shpejtë. Ai padurim dhe fjalët e tua falenderuese më futën nëpër vite kur ti ishe fëmijë dhe unë i ri, por jo ky që jam sot në moshë dhe në mendime. Atëherë isha shpërthyesh i parrahur nga valët e jetës, që shkruaja siç shkruan ti, por jo si ti!

Ti me këto poezi ma kalon mua shumë herë. Unë shkruaj vetëm në tabanin e vargëzimeve popullore, të këngëve që këndoja në rini, kurse ti shkruan shumë më dryshe nga mua. Ti je, poete e talentur!

Te poezitë e tua në këtë vëllim poetik derdhen fjalë nga shpirti me një ndjenjë të thellë për njojjen e kontraditave të jetës, që bazën e kanë gjithmonë tek mungesa e dashurisë, sepse njerëzit pak e njojin dashurinë dhe aspak nuk dinë të dashurojnë me zemër, larg interesave meskine, të një bote të pa shpirt.

Te poezitë e tua unë shoh edhe shpërthimin tim, që nuk e shpreh dot ashtu si ti. Je gjaku im e nuk ka si të jesh ndryshe. Nuk doja të më ngjaje mua për disa gjëra, që dhe mua nuk më pëlqejnë te vetja dhe shumë mirë që nuk më ngjave! Por jam krenar që më ngjave në shpirt dhe në rrugën e artit, ndaj të uroj thellë nga zemra, që prej këtij vëllimi të parë me poezi të marrin rrugë ëndrrat e tua.

U shtofshin pa pushim librat dhe sukseset në të gjitha fushat e jetës. Paç shëndet dashuri e lumturi pafund, si bazë e gjithë bazave të jetës  
Me dhembshuri dhe dashuri!

Petrit Mënaj

## NJOHJA ME JETËN E NJË POEZIE

Është hera e parë, që me një tufë poezish, që frymojnë me frymën e dashurisë, të takohem, për të njojur jetën e një poezie, që kohës mëton t'ia dhurojë motin, ku dashuria e ka fjalën.

Jo thjeshtë si një dashuri, që di të shfaqet mes rrugëve të jetës, por si një dashuri që ecë rrugëve të jetës, për të mbetur fat, ku qepen shtigjet, për të mbetur vetëm lumturia si shtrat ku e merr gjumin dashuria.

E theksuam këtë thënie si shënim sipërfaqësor biografik e gjeografik, për të parë se jeta e poezisë së poetes Endrikeda Mënaj, që jetëson librin "E lirë për të dashuruar", është e qëndisur në fushën e një shpirti, që thekson dy elemente dalluese dhe mbasse mjaftë interesante në krijimtarinë letrare shqipe të kohës së re:

- Tema e dashurisë dhe,
- Simbolikat, që zënë vend meritor në të gjitha poezitë, si motiv e ide, për dashurinë.

Ndaj, lirshëm mund të them se: ndoshta janë këto elemente tejet të dukshme, që ndoshta, motive të tjera që mund t'i dijë vetëm poetja, rreshtohen mes rreshtave me gjuhën e të gjitha varianteve për të mbetur si simbol trazimi, rrugëve të jetës, që dashuria të mos mbetet e përgjumur.

Këtë e them, sepse nuk do të doja të mbetem i pa kuptuar, duke u përflakur e përcëlluar jo vetëm në hapësirën tokësore të kësaj poezie, por, në atë shpirtërore e më shumë në atë njerëzore, që e shfaq poetja Endrikeda Mënaj në librin “E lirë për të dashuruar”, që duket si një metaforë, apo më mirë të themi si një luftë jetike, ku fitimtare del dashuria.

Jo vetëm në aspektin e dashurisë si nevojë jetike, por edhe të imagjinatës poetike, poetesa Endrikeda Mënaj, i ka sendërtuar si vlera letrare me një estetikë të përpunuar, të gjitha lirikat e këtij libri, që kohës i mbeten, si:

- jetë,
- halle,
- përpjekje,
- triumf dhe,
- kujtesë.

Prandaj, mund të shprehemi se poetesa Endrikeda Mënaj, me librin e saj “E lirë për të dashuruar”, ka ca simbolika, ku nuk ka vija dalluese mes jetës reale dhe imagjinatës, ngase, shikuar si tërësi poetike, poezinë në fjalë, na e shfaqjeta reale përballë e autores dhe përbërja e saj si qenie njerëzore, që nuk lejon që poezia t'i takoj imagjinatës, edhe kur ajo ecën në mënyrë

estetike për t'u sajuar si një krijim lirik për të portretizuar më mirë vetën, në kohë e hapësirë.

Këtë që e thamë, na e dëshmon jeta e lirikave ose më mirë thënë, poezitë me motiv dashurie, që i ndeshim kudo, në secilën poezi dhe gati në secilin varg.

Pra, libri në fjalë i poetes Endrikeda Mënaj, si tërësi organike është lirikë më vete, kudo ka ndjenjë dashurie, erë luleje, fluturim zogu, dhe shpresë për fitore. Me këtë rast, vetëm sa për ilustrim po citojmë disa vargje të shkëputura nga poezi të ndryshme në të cilat dëshmohet se poetja e ka ndërtuar lirikën e dashurisë me mjaft kujdes dhe me një brishtësi specifike:

Jetën e mbylla në një gonxhe,  
gonxhen ta dhurova ty,  
Përse ti petalet ia këpuse?  
Përse jetën ma le përgjysmë?

Ose:

M'u m'pleksën kujtimet në valët e detit,  
Në to u hodhe dhe ti.  
Notove, humbe diku në thellësi  
Dhe prej teje më mbeti vetëm kujtimi.

Ndaj, mund të themi se: lirikat e këtij libri nuancojnë, përkatësisht synojnë vlera të arrira që shoqërohen me gjuhën e motiveve, që dashuria kudo ta ketë fjalën, jo vetëm si një e përjetuar jetike, por edhe si një e kërkuar kur ajo di të humbet mes nesh.

Kështu që, poetesa Endrikeda Mënaj, ecën si një penë e rrallë e kohës mbi këto vlera dhe mbi këto refleksione, duke e ndërtuar poezinë e saj, poezi e cila siç theksuanë më lart, është rezultat i ndikimeve të rrëthit dhe rrëthanave të gjithëmbarshme.

Ndaj lirshëm mund të themi se edhe semantika, përkatësisht kuptimi i këtyre ideve, nocioneve dhe i metaforave të shumta është një krijim mjaft kompleks, sepse kjo poeteshë me një konsekuençë i ka ndjekur dhe u ka ndenjur besnik parimeve dhe ideve për të ndërtuar konceptin poetik në njëren anë, kurse në anën tjetër i ka artikuluar fuqishëm zhvillimet e realitetit jetësor që duket se është vetë jeta, që poeteshën e rrëthon.

Duke përmbyllur këtë shënim, mbi librin “E lirë për të dashruar”, të poeteshës Endrikeda Mënaj, po sintetizojmë një përkufizim: Poezia e poeteshës në fjalë, kohës dhe letrave shqipe do t'u mbetet si një poezi e ndjenjave të thella dhe e kujdesit estetik, poezi e ylerave dhe e kërkimeve

të vazhdueshme për një shprehje më të bukur, më të avancuar dhe një poezi me vlerë të qëndrueshme pasi në masë të madhe poetesa ia ka arritur qëllimit, që ta thotë fjalën e vet:

Unë jam poezia, unë jam vetë dashuria,  
ndaj dhe jo rastësisht librin e ka pagëzuar “E lirë  
për të dashruar”, që e vërteton atë që u  
lartëshkrua, duke e përmbyllur poezinë me  
poemën, që edhe e pagëzon këtë libër poetik.

**Rami KAMBERI**